

Liljana Çoçoli

Mban pozicionin e Drejtorit të Verifikimit të Figurave në Drejtorinë e Përgjithshme të Trajtimin të Kërkesave prej gushtit të vitit 2023, si edhe të Kordinatorit për të Drejtën e Informimit pranë Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e Ish Sigurimit të Shtetit prej qershorit të vitit 2022.

Është diplomuar pranë Universitetit të Bukureshtit, Rumani, ku është licencuar në shkencat juridike, profili shkenca juridike prej vitit 1998.

Znj. Çoçoli është licencuar në profesionin e avokatit nga Dhoma Kombëtare e Avokatisë.

Në karrierën e saj profesionale, ka punuar si Juriste dhe më pas ka mbajtur pozicionin Përgjegjëse e Sektorit të Administratës në Drejtorinë e Përgjithshme të Qendrave Studentore në Ministrinë e Arsimit dhe Shkencave; si juriste pranë “Albafilm” sh.a.; si Specialiste e Sektorit Juridik dhe Prokurimeve e më pas në pozicionin e Përgjegjësit të Sektorit të Kërkesave Institucionale dhe të Kordinatorit për të Drejtën e Informimit pranë Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e Ish Sigurimit të Shtetit.

Znj. Çoçoli, ka kryer trajnime Brenda dhe jashtë vendit në fushën e jurisprudencës.

Drejtoria e Verifikimit të Figurave përgjigjet për :

- Verifikimi i pastërtisë së figurës së kandidatëve për poste të larta në institucionet kushtetuese dhe autoritetet publike, lidhur me ekzistencën e informacioneve në dokumente të ish-Sigurimit të Shtetit, kur kjo kërkohet në kuadër të vlerësimit, sipas legjislacionit përkatës, për t’u emëruar ose ngritur në detyra.
- Verifikimi pastërtisë së figurës së kandidatëve për deputetë në Kuvendin e Shqipërisë, kryetarë bashkish dhe kryetarë këshilli qarku, në lidhje me ekzistencën për ta të informacioneve në dokumente të ish-Sigurimit të shtetit, kur kjo kërkohet për qëllime të transparencës së figurës, gjatë fushatave elektorale.
- Verifikimin për personat që propozohen për dhënie dekoratash, tituj nderi, medalje dhe titujt vendorë të nderit nga institucionet përgjegjëse dhe organet e pushtetit vendor.
- Informimi i institucioneve kushtetuese, autoriteteve publike dhe subjekteve të tjera të interesuara, për dokumentet e ish- Sigurimit të Shtetit, të identifikuara dhe garantimi për shqyrtimin e tyre.